



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

NJOFTIMI PËR KONSULTIM PUBLIK TË PROJEKTVENDIMIT, “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE”

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Postuar më: 31.07.2017

Ministria

e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave shpall për konsultim publik, Projektvendimin

“Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”

QËLLIMI (DRAFT) STRATEGJISË:

Projektvendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit, "Për miratimin në parim të strategjisë Kombëtare të menaxhimit të Integruar të burimeve ujore,

2017-2027", i propozuar për shqyrtim dhe miratim në

Këshillin Kombëtar të Ujit ka si qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, i cili është përgatitur në kuadrin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore me nr. Ref. MEFWA/CS/003 "Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore", në kuadër të Komponentit 3 të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (SMIBU) është përgatitur nga konsulenti Mott MacDonald, në bashkëpunim me Abkons dhe GR Albania, i financuar nga Banka Botërore dhe SIDA.

Strategjia Kombëtare e

Menaxhimit të Burimeve Ujore, 2017-2027 (SKMIBU) është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumentave të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse.

Menaxhimi i Integruar

i Burimeve Ujore (MIBU) përkufizohet si "një proces që nxit zhvillimin dhe menaxhimin e bashkërenduar të ujit, tokës dhe burimeve përkatëse, për të rritur në maksimum mirëqenien ekonomike dhe sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa kompromentuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve jetësore".

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore (MIBU) në vend do të

arrihet nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, ekonomik, institucionale, teknike dhe sociale duke u bazuar në legjisllacionin Evropian për mjedisin dhe parimet e MIBU-s.

Proçesi i zhvillimit të Strategjisë MIBU për Shqipërinë është

hartuar në mënyrë të tillë që të ofrojë një kornizë për administrimin gjithëpërfshirës të burimeve ujore, në të cilin të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe sektorin privat, shoqërinë civile dhe komunitetet

përdoruese, pavarësisht nga gjinia, të luajnë një rol aktiv.

Strategjia integron objektivat e politikave ekzistuese shqiptare duke marrë parasysh rreziqet që pritet të vijnë nga ndryshimet klimatike bazuar në katër 'shtylla' strategjike: 'Ujë për Njerëzit', 'Ujë për Ushqim', 'Ujë për Industrinë', dhe 'Ujë për Mjedisin'

Qëllimi i procesit
te konsultimit publik:

Rekomandimet dhe komentet nga qytetaret, grupet e interesit do të ishin një kontribut i vyer për të hartuar një dokument strategjik gjithëpërfshirës.

Ju ftojmë të dërgoni komentet dhe rekomandimet Tuaja, brenda 40 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, në adresën: erola.rada@bujqesia.gov.al

Më poshtë gjeni draft Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore dhe Relacionin shoqëruar të Vendimit të KKU-së për miratimin e këtij dokumenti,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Dokumenta:

- [PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, 2017-2027"](#)
- [Relacioni RELACIONI PER PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, 2017-2027"](#)

Diskutimet
